

VENDIM
Nr.544, datë 15.8.2007

PËR DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 14, e 20 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.151 datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Komisioni Qendror i statusit “Dëshmor i Atdheut” mbështetet nga një staf teknik, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja e të cilit përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes.

Përgjegjësi i këtij stafi ushtron funksionet e sekretarit të Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a” bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Pas fjalëve “...këshillit të qarkut...” shtohen “... ose të prefektit...”

ii) Fjalët “ ... në Departamentin e Veteranëve dhe të Invalidëve të LANÇ-it dhe të statusit “Dëshmor i Atdheut” .. .” zëvendësohen me “... pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të statusit” “Dëshmor i Atdheut”....”

b) Paragrafi i dytë i shkronjës “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kërkesën, në emër të familjes, e paraqet njëri nga pjesëtarët, bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët përfitues, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare, në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut.”.

"c) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Komisioni Qendror për statusin “Dëshmor i Atdheut”, pasi shqyrton kërkesën dhe dokumentet përkatëse, së bashku me relacionin e stafit teknik, që përmban një përshkrim të shkurtër të jetës dhe veprimtarisë së personit, vlerësimin e dokumenteve shtetërore, që vërtetojnë kërkimin dhe njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, bazën ligjore mbi të cilën mbështetet kërkesa, për njohjen këtij statusi, si dhe mendimin për përfitimin ose jo e statusit “Dëshmor i Atdheut”, merr vendim për njohjen ose jo të këtij statusi dhe njofton të interesuarin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha